



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11.6 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106, nenit 12 paragraf 1.1 të Rregullores nr. 04/2015 për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve (MKRS), dhe nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 të Statutit të Teatrit të qytetit “Avdush Hasani” – Podujevë nr.prot.01-640-93374 të datës 28.12.2016, në pajtim me Shkresën nr.prot.02-129/2 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nënkyetari i Komunës, merr;

VENDIM PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT PUBLIK TË QYTETIT “AVDUSH HASANI” NË PODUJEVË

Neni 1

Emërohet Këshilli Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë, me mandat katër (4) vjeçar, në përbërje:

1. Ismet Azemi, aktor
2. Ramë Oraca, poet
3. Elhame Kutllofci, regjisore
4. Saranda Kika, piktoe
5. Nazmi Elezi, fakulteti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe - përfaqësues i Komunës.

Kryetari/ja i Këshillit Drejtues zgjedhet në mbledhjen e parë me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet, Këshilli Drejtues, i ushtron në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa për punën e kryer kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Kryetari të Komunës, Këshilli Drejtues i Teatrit, i paraqet raport të punës së paku një (1) herë në vit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04-0024555/20
Podujevë,
01 qershor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 parag 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 sipas kërkesës së proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, nr.02-400/01-0024304/20, datë 01 qershor 2020, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ- NË SHKOLLA E KITARES “MIRELA” NË PODUJEVË

Neni 1

OJQ-Shkolla e Kitares “Mirela“ në Podujevë, për pjesëmarrje në Festivalin ndërkombëtar që zhvillohet në Shqipëri – Tiranë, mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00 €.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti të lidh kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ-Shkolla e Kitares “Mirela“.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/03-0024489/20
Podujevë, 01 qershor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, në pajtim me Shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE znj.MEVLUDE HALILI NGA FSHATI SFEÇËL KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

znj. Mevlude Halili, nga fshati Sfeçël, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë sociale-ekonomike dhe të banimit, i jepet ndihmë financiare, në shumë 300 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të të përmendurës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Nr.02-400/01-0027341/20
Podujevë, 11 qershor 2020



Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61.3 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

VENDIM

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR MBIKQYRJEN DHE PËRCJELLJEN E FUSHATËS PËR KORRJE-SHIRJE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2020

Neni 1

Ngritet Komisioni komunal për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e fushatës për korrje-shirje në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2020, në përbërje:

1. Behë Govori kryesues
2. Rrahman Cakiqi anëtar
3. Afrim Mulliqi anëtar

Neni 2

Komisioni bën mbikëqyrjen dhe kujdeset për mbarëvajtjen e fushatës së korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Për punën e kryer Komisioni në formë të shkruar informon Nënkyetarin e Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit

Drejtorit të DBPZHR

Zyrës së Informimit

Nr.02-020/04-0028422/20
Podujevë, 16 qershor 2020



Nënkyetari i Komunës
Nexhmi Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 24.1 të Ligjit nr. 04/L-075 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport, nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, Rregulloren për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/172-400, në pajtim me shkresën e MAPL nr. prot. 02-129/2 datë 06.02.2020, nxjerr:

VENDIM

I.

Lejohen mjete financiare në shumë 5000 € për Klubin e Futbollit Llapi në Podujevë për pjesëmarrje në garat/turneun e organizuar në qytetin Velbert të RF të Gjermanisë, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjelltë dhe partneritetit zyrtar në mes të dy qyteteve Podujevë -Velbert .

II.

Klubi mbështet në cilësinë e përfaqësuesit të Komunës së Podujevës dhe përveç pjesëmarrjes në gara/turne ka për qëllim edhe bashkëpunim dhe promovimin e futbollit si dhe shkëmbimin e përvojave me klubet sportive evropiane.

III.

Lejimi i mjeteve bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë të KF Llapi, i cili obligohet të sjellë raport në formë të shkruar në DKRS.

IV.

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

V.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/05-0029129/20
Podujevë, 17 qershor 2020

Nënkryetari i Komunës
Nexhmi Rudari





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 10 parag.1 shkronja b) të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR BOTIMIN E LIBRIT DRAMATURGJIK ME TITULL “ DRAMË”

Neni 1

z. Naser Shatrolli, nga Komuna e Podujevës, për botimin e librit dramaturgjik me titull; DRAMË (6 tekste teatrore), mbështetet me mjete financiare, në shumë 1000 €.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e z.Naser Shatrolli.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-400/01-0030694/20
Podujevë, 24 qershor 2020



Nënkyetari i Komunës
Nexhami Rudari



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja n) dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr.03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore, dhe neneve 16, 19 paragrafi 14 dhe nenin 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Raportit/rekomandimit (nr.prot.02-024/01-0030701 datë 24.06.2020) të Komisionit për shqyrtimin të OJQ-ve për licencim si Qendra Rinore Publike i themeluar nga Kryetari i Komunës me Vendimin nr.prot.02-020/04-0085534/19 datë 04.11.2019, Në pajtim me Shkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.prot.02-129/2 të datës 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, nxjerrë,

VENDIM

PËR LICENCIMIMIN E OJQ “LIDHJA RINORE BLUE”, SI QENDËR RINORE PUBLIKE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim, Licenohet OJQ “Lidhja Rinore Blue”, si Qendër Rinore Publike në Komunën e Podujevës.

Neni 2

OJQ sipas nenit 1 licenohet, ndër të tjera, me qëllim të ofrimit të hapësirës dhe mundësive për aktivitetet dhe veprimtarive programore të rinjve si dhe mundësive për zhvillimin e veprimtarive edukative joformale dhe veprimtarive të tjera të planifikuara nga të rinjtë, bashkëpunimin me OJQ tjera në aktivitete të përbashkëta dhe pjesëmarrje në procese të vendimmarrjes, si dhe çështje tjera të parapara me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 3

OJQ “Lidhja Rinore Blue” licenohet për periudhën 4 (katër) vjeçare.

Neni 4


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

u dërgohet;

- Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
- OJQ-së, “Lidhja Rinore Blue”
- Arkives

Nr.prot. 02-020/04-0030781/20
Podujevë,
24 qershor 2020





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E KRYETARIT

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (10.1 shkronja e), sipas shkresës së MAPL nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkyetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

Për pranimin e kamionit zjarrfikës ISUZU: NPR10, i dhënë donacion nga Ambasada Japoneze në Kosovë, sipas Marrëveshjes së nënshkruar me Shërbimin e Zjarrfikësve të Komunës së Podujevës, datë 19 mars 2020 ngritet komisioni, në përbërje:

1. Milaim Ajvazi, kryesues
2. Rafet Bekteshi, anëtar
3. Vedat Maloku, anëtar

Donacioni do të pranohet nga operatori ekonomik “Agribau” sh.p.k Prishtinë, i kontraktuar nga Ambasada Japoneze në Kosovë.

Neni 2

Komisioni duhet të verifikoj dhe të pranoj kamionin sipas specifikave teknike dhe pajisjet zjarrfikëse të parapara me kontratë.

Neni 3

Për punën e kryer, Komisioni i paraqet raport në formë të shkruar Zyrës së Kryetarit.

Podujevë, 24 qershor 2020



Nënkyetari i Komunës
Nexhimi Rudari



ZYRA E KRYETARIT

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2020 dhe parashikimet buxhetore 2021-2022 nr.01-400/03-0075925/19, dt. 23.09.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr. 12-320/01-0021224/20, dt. 05.05.2020, në pajtim me shkresën e MAPL-së nr. 02-129/2 datë 06.02.2020, Nënkrjetari i Komunës, merr:

V E N D I M PËR MBËSHTETJEN E BLETARËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Mbështeten 150 (njëqind e pesëdhjetë) bletar përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Përkrahja e bletarëve me mjete pune, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe atë:

- **120 bletarë në Grupin e parë**, me (Centrifugë mekanike për 4(katër) korniza, Vaska - inoks 3(tri) shtëpiza, 3(tri) katëshe antivarro, Uniforma dhe doreza, Tymosja inoks, Kullojsa inoks me dy sita, Çelësi – inoks).
- **30 bletarë në Grupin e dytë**, me (Makinë për përpunimin e dyllit, 3 (tri) shtëpiza, 3(tri) katëshe antivarro, Uniforma dhe doreza, Tymosja inoks, Kullojsa inoks me dy sita, Çelësi – inoks).

Neni 2

Mbështetja e bletarëve bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bletarisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Listat e përfituesve sipas nenit 1 janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 4

Zbatimin e Vendimit e bënë Drejtorja e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/05-0031652/20
Podujevë, 26 qershor 2020

Nënkrjetari i Komunës
Nexhmi Rudari

